



2017-2018

**Kodi i Sjelljes së
Nxënësit
(Albanian)**



Drejtoria Arsimore e Filadelfias



Komisioni Reformës Shkollore

Kryetar

Joyce S Wilkerson

Komisionerë

William Green

Farah Jimenez

Dr. Christopher McGinley

Estelle B. Richman

Superintendent

Dr. William R. Hite, Jr.

Zëvendës Kryetar për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Nxënësit

Rachel Holzman, Esq.

Kodi i Sjelljes së Nxënësit do të jetë efektiv për një periudhë pesëvjeçare dhe është subjekt i ndryshimeve prej Komisionit të Reformës Shkollore(SRC).

Zotimi i Nxënësit

Si nxënës i Drejtorisë Arsimore të Filadelfias, betohem se do të ndjek Kodin e Sjelljes së Nxënësit, **të respektoj të tjerët dhe** veten time dhe të trajtoj çdonjërin në komunitetin e shkollës time ndershmërisht dhe me konsideratë.

Unë e kam të qartë dhe jam dakord, që mjedisi në shkollë duhet të jetë pozitiv dhe bashkëpunues, në mënyrë që secili të mund të mësojë.

Unë e kuptoj, që frekuentimi i përditshëm i shkollës është çelësi i suksesit tim.

Unë e kuptoj, që violenca dhe sjellja e keqe, si edhe gjuha abuzive e përdorur, **janë të papranueshme** dhe nuk do të tolerohen.

Duke e firmosur këtë zotim, Unë i kuptoj dhe pranoj përgjegjësitë që rrjedhin nga Kodi i Sjelljes së Nxënësit, për aq kohë sa jam nxënës i Drejtorisë Arsimore të Filadelfias.

Firma e Nxënësit:

Zotimi i Drejtorisë Arsimore

Si një pjestar i Drejtorisë Arsimore të Filadelfias, Unë e kuptoj, që luaj një rol kryesor në krijimin e një mjedisi të sigurtë dhe pozitiv për të gjithë nxënësit. Unë zotohem të ndjek Kodin e Sjelljes së Nxënësit, **të respektoj të tjerët** dhe veten time dhe t'i trajtoj të gjithë të tjerët në komunitetin e shkollës me ndershmëri dhe konsideratë.

Unë angazhohem të zhvilloj procesin e mësimin.

Unë angazhohem të mbështes mësimin përmes krijimit dhe mbajtjes së një mjedisi të rregullt, të sigurtë dhe angazhues.

Unë angazhohem të nxis komunikimin e respektueshëm të dyanshëm me të gjithë pjestarët e shkollës dhe të komunitetit.

Unë zotohem të zbatoj Kodin e Sjelljes së Nxënësit me ndershmëri dhe në mënyrë të vazhdueshme.

Firma e Administratorit:

Zotimi i Prindit/Kujdestarit

Si pjestar i komunitetit shkollor të fëmijës tim, Unë e kam lexuar dhe kuptuar Kodin e Sjelljes së Nxënësit dhe jam dakord të mbështes qëllimet e tij, për aq kohë sa do të jem pjestar i komunitetit të kësaj shkolle.

Unë e kuptoj, që luaj një rol kryesor në krijimin e një mjedisi, ku procesi mësimor është në plan të parë.

Unë do të vë theksin, te fëmija im, për rëndësinë e sjelljes së mirë dhe pasojat që rrjedhin nëse ai, ose ajo thyejnë rregullat e Kodit të Sjelljes së Nxënësit.

Unë e kuptoj rëndësinë dhe pres që të kem një komunikim të hapur me Drejtorinë Arsimore të Filadelfias, në rastet kur ka probleme të sjelljes dhe disiplinës në shkollë të fëmijës tim.

Unë zotohem që të mbështes pozitivisht fëmijën tim, për të nxitur frekuentimin e përditshëm të tij/saj dhe krijimin për të gjithë të një mjedisi sa më të mirë për mësim.

Firma e Prindit/Kujdestarit: _____

KUJTESË: Kodi i Sjelljes së Nxënësit është i plotë në uebsajtin e Drejtorisë Arsimore -
https://webapps.philasd.org/stor/Code_of_Student_Conduct_Albanian.pdf

Kodi mund të merret si broshurë në drejtorinë e shkollës, ose nga Zyra e Përfshirjes së Familjes dhe Komunitetit, me telefon 215-400-8480, ose website – www.philasd.org/language/albanian

Për kopje në gjuhën tuaj, kontaktoni Zyrën e Përkthimeve dhe Interpretimeve me numër 215-400-4180, ose në Uebsajtin:
<http://webqui.phila.k12.pa.us/offices/t/translation>

Qëllimi i Kodit të Sjelljes së Nxënësit

- Të mbështesë krijimin e një mjedisi të sigurtë për mësim, për të gjithë pjestarët e komunitetit të shkollës.
- Të ofrojë pritshmëri të qarta dhe të hollësishme, për sjelljet sociale në gjithë mjediset e shkollës.
- Të sigurojë administratorët për ndërhyrjet në shkollë, që trajtojnë sjelljet e dënueshme të nxënësve

Mbrojtja dhe siguria e të gjithë fëmijëve të shkollës, është prioriteti ynë parësor dhe Drejtoria Arsimore e Filadelfias është e vendosur të sigurojë një mjedis mësimor të sigurtë.

Politika e Drejtorisë për Siellien

Kodi i Sjelljes së Nxënësit përcakton politikat, rregullat dhe pritshmëritë për të gjithë pjestarët e komunitetit shkollor, që mësojnë dhe punojnë sëbashku. Këto janë pritshmëri të cilat ndërtohen në respektin për njeri tjetrin, si vlerë e përbashkët e jona. Në këtë mënyrë vazhdohet që nxënësit duhet të shmangin dhunën ndaj të tjerëve, sjelljen brutale, kërcënimet dhe mbajtjen e armëve.

Pasojat për nxënësit që përfshihen në prishjen e sigurisë në shkollë, ose prishin procesin e mësimin të të tjerëve, përshkruhen gjithashtu me detaje. Kodi i Sjelljes së Nxënësit zbatohet në shkollë dhe në rrugën gjatë vajtjes dhe kthimit nga shkolla, por nuk kufizohet nëse udhëton me mjetet e Drejtorisë Arsimore, me transport privat dhe atë publik.

Familjet dhe kujdestarët janë pjesë kryesore e komunitetit të shkollës tonë. Ne kërkojmë që ata të jenë të lutur të lexojnë dhe kuptojnë Kodin e Sjelljes së Nxënësit dhe Manualin Shkollor të Nxënësit si edhe ti diskutojnë ato me fëmijët e tyre. Ne e kuptojmë që familjet dhe kujdestarët e dinë më mirë se si të bëjnë më të mirën, që fëmijët e tyre të kuptojnë pritshmëritë, që çojnë në një komunitet shkollor të rregullt dhe të sigurtë, që është i gatshëm për të mësuar.

Kodi i Sjelljes së Nxënësit jep përcaktimet e shkeljeve të sjelljes. Megjithatë disa përcaktime.

Prindërit dhe kujdestarët, që kanë ndonjë pyetje ose shqetësim, janë të mirëpritur të kontaktojnë drejtorin e shkollës dhe/ose Zyrën e Të drejtave dhe Përgjegjësive të Nxënësve, në numrin 215-400-8480 ose website – <http://webgui.phila.k12.pa.us/offices/s/student-rights-and-responsibilities>

Përgjegjësitë e Mësuesve

- Të respektojnë të gjithë pjestarët e komunitetit të shkollës.
- Të përdorin vlerësim profesional, për të parandaluar që incidentet e vogla të kthehen në probleme të mëdha.

Sjellja: Pritshmëritë & Përgjegjësitë

Përgjegjësitë për Secilin

- Të respektojnë të gjithë pjestarët e komunitetit shkollor.
- Të mbajnë një klimë pozitive në shkollë, duke qenë të përgjegjshëm, të respektueshëm dhe bashkëpunues.
- Të komunikojë pritshmëritë e Kodit të Sjelljes së Nxënësit për nxënësit dhe stafin.
- Të motivojë nxënësit për të lartësuar pritshmëritë, nëpërmjet

shembujve pozitivë.

- Të përdorë vlerësim të saktë për të parandaluar, që incidentet e vogla të bëhen problem i madh.

Përgjegjësitë e Administratorëve

- Të respektojnë të gjithë pjestarët e komunitetit të shkollës.
- Të zbatojnë Kodin e Sjelljes së Nxënësit dhe të gjithë procedurave disiplinore me ndershmëri dhe në mënyrë të vazhdueshme.
- Të ofrojnë për nxënësit dhe prindërit e tyre që flasin gjuhë tjetër nga ajo Angleze, shërbime përkthimi dhe interpretimi falas.
- Të informojnë personelin e shkollës, prindërit dhe nxënësit me politikat disiplinore.
- Shqyrtojnë dhe veprojnë ndaj akuzave dhe kërkesave të personelit të shkollës, që lidhen me shkeljet disiplinore.
- T'u mësojnë sjelljen e duhur nxënësve dhe të forcojnë rregullat e sjelljes.
- Të mbajnë një mjedis mësimor, që ndikon në suksesin akademik.
- Të mbajnë nxënësit përgjegjës për sjelljet e dënueshme në shkollë dhe mjediset e saj.
- T'i adresojë thyerjet disiplinore me strategji të shumfashita për mbajtjen e nxënësve në shkollë
- Të përdorin vlerësim profesional, për të parandaluar që incidentet e vogla të kthehen në probleme të mëdha.

Përgjegjësitë e Nxënësve

- Të respektojnë të gjithë pjestarët e komunitetit të shkollës.
- Të kuptojnë dhe të sillen në pajtim me rregullat e shkollës dhe pritshmëritë, duke përfshirë Kodin e Sjelljes së Nxënësit dhe Manualin e Shkollës për Nxënësin.
- Të veprojnë në pajtim me politikat e Drejtorisë Arsimore për frekuentimin, kodin e veshjes, mungesat e paarsyeshme dhe atë kundër sjelljeve brutale.
- Të sillen në mënyrë të tillë, që përqëndrimi të jetë në suksesin mësimor.
- Të jenë të përgjegjshëm dhe përgjegjës për ndjekjen e rregullave.

Përgjegjësitë e Prindërve / Kujdestarëve dhe Avokatëve

- Të respektojnë të gjithë pjestarët e komunitetit të shkollës.
- Të respektojnë, kuptojnë dhe mbështesin rregullat dhe rregulloret e shkollës.
- Të respektojnë, kuptojnë dhe mbështesin politikat e Drejtorisë Arsimore.
- Të njohin dhe kuptojnë faktin, që personeli duhet të zbatojë rregullat e shkollës.
- T'u mësojnë fëmijëve të respektojnë të drejtat e të tjerëve dhe të zbatojnë rregullat e shkollës.
- Të theksojnë rëndësinë e përgatitjes për në shkollë dhe respektimin e rregullave si nxitje për suksesin mësimor.

Pritshmëritë e Kodit të Veshjes

Nxënësit priten të ndjekin kodin e veshjes së shkollës së tyre, në mënyrë që pamja e tyre nuk do të krijojë premisa për rrezik shëndeti apo sigurie. Drejtorët e shkollave duhet të përcaktojnë dhe të shpallin vendimin përfundimtar për atë që duhet konsideruar e

përshtatëshme ose jo. Për informacion në lidhje me kodin e veshjes të shkollës, ju lutemi konsultoni Manualin Shkollor të Nxënësit.

Shkelja e Kodit të Veshjes nuk do të ndëshkohet me përjashtim nga klasa. Thyerjet e përsëritura të kodit të veshjes, mund të çojnë në ndëshkim jashtë orëve të mësimi.

Drejtorët mund të shpallin ditët e veçanta, ose të klubit dhe të lejojnë nxënësit të veshin këmbisha të ndryshme të klubeve, ose të planifikojnë ditë të veshjes ndryshe (p.sh. një ditë kur nxënësit dalin në fotografi), ose të lejojnë nxënësit të vishen me veshje të tilla si, veshje për Bojskaut, Gërlskaut, çitëlidërs, veshje atletike, bande, kori etj. Në Kodin e Sjelljes së Nxënësit, nuk parashikohen kufizime ose ndalime për veshjet fetare. Prindërit që kanë shqetësime në lidhje me veshjen fetare, janë të inkurajuar t'i trajtojnë ato me drejtorët.

Nxënësit kanë të drejtë të vishen në përputhje me identitetin gjimor të tyre të shpallur dhe/ose shprehite në kuadrin e kodit të veshjes së shkollës.

Pyetje të tjera në lidhje me kodin e veshjes duhet të referohen më parë tek drejtorët e shkollës, ose i ngarkuari për këtë problem.

Kërkesat e Frekuentimit të Shkollës

Në kontenë e Filadelfias, frekuentimi i shkollës është kërkesë për të gjithë fëmijët e moshës 6 deri në 17 vjeç. "Të ndjekësh shkollën" do të thotë, që një fëmijë duhet të jetë i regjistruar dhe ndjekë një shkollë publike, shkollë çartër, shkollë çartër cyber, shkollë private ose me bazë fetare, ose të marrë pjesë në një program shkollor të aprovuar, që ndiqet në shtëpi.

Rregullat e Departamentit të Arsimit të Pensilvanisë parashikojnë, se fëmijët, konsiderohen në moshë shkollor nga koha që ata janë PRANUAR në një program arsimor të shkollës publike, deri në diplomimin nga shkolla e mesme, ose deri në moshën 21 vjeç. Prandaj, gjatë kohës që fëmija është në moshë shkollor, fëmija ose nxënësi ka të drejtë të ndjekë shkollat publike, ose një shkollë çartër. Nxënësit, të cilët bëhen 21 vjeç gjatë periudhës shkollorë, kanë të drejtë të përjashtohen nga ky rregull..

Nga prindërit/kujdestarët priten që:

- Sigurojnë që fëmijët e tyre mes moshës 6 deri në 17 vjeç janë të regjistruar në shkollë dhe e ndjekin atë rregullisht, në orar dhe gjatë gjithë ditës.
- Theksojnë rëndësinë e frekuentimit në orar, në shkollë, klasë, dhe aktivitetet e mbikëqyrura. — dhe festojnë frekuentimin e mirë dhe rezultatet pozitive.
- Dërgojnë fëmijën e tyre çdo ditë të përgatitur për të marrë pjesë aktivisht dhe të mësojë në klasë, duke siguruar që ata bëjnë një gjumë të mirë dhe të kenë ngrënë mëngjes.
- Vendosin orare të kufizuara, por të arsyeshme dhe sipas moshës, për të ardhur në shtëpi dhe/për të fjetur në orar.

Pritshmëritë e Frekuentimit

- Përpiqen të lënë takimet personale për fëmijën, jashtë orarit të mësimi, ose gjatë pushimeve të shkollës.
- Planifikojnë kohë të përshtatëshme për mësim dhe gjumë
- Sigurojnë që fëmija i tyre bën vizitat periodike të shëndetit, të detyruara me ligj.
- Planifikojnë pushimet me familjen, që të përkojnë me pushimet e shkollës
- Telefonojnë shkollën, kur fëmija mungon.
- Pajisin fëmijën me letër me shkrim, për çdo mungesë kur ai/ajo kthehet në shkollë
- Pajisin fëmijën me një arsye me shkrim për çdo vonesë në shkollë, ose largim më herët nga shkolla.
- Pajisin shkollën me adresën e saktë aktuale, kontaktet e emergjencës, telefonat e shtëpisë, punës, celularët, adresën elektronike (email) në fillim të çdo viti shkollor dhe të rifreskojnë informacionin sa herë ka ndonjë ndryshim.
- Ndhimojnë në zhvillimin dhe zbatimin e planit individual për përmirësimin e frekuentimit të fëmijës, nëse është e nevojshme.

Kur Mund të Mungojë një Fëmijë?

Në disa raste nxënësi do të mungojë në shkollë. Këto "mungesa të arsyeshme" përfshijnë përfshijnë raste të tilla si sëmundje ose lëndime, Leje lindjeje për prinëdr adoleshentë (6 javë ose 30 ditë shkollorë), leje nga prindi (vetëm me shkrim dorazi), mungesë në raste të një vdekjeje/funerali në familje (shiko më poshtë), aktivitete ose ekskursione të karakterit edukativ, pezullim nga mësimi, dhe në raste festash fetare. Menjëherë, kur nxënësi kthehet në shkollë pas mungesës, duhet të paraqesë një shënim me shkrim nga prindi ose kujdestari. Ky shënim duhet të përfshijë një numër telefoni ose mënyrë tjetër të kontaktimit të prindit për qëllime verifikimi. Vërtetim lidhur me mungesën/dëmtimin/apo në raste të tjera, kërkohet, kur mungesat kalojnë 3 ose më shumë ditë në vazhdimësi. Pas ditës së tretë drejtori, ose zëvendësi i pranojnë ose e refuzojnë këtë shënim.

Një mungesë "pa arsye" ose "jo ligjore" ndodh, kur një nxënës mungon pa paraqitur një arsye bazë. Kjo do të thotë se nxënësi nuk ka paraqitur as shënimin me shkrim, kur është kthyer në shkollë, apo se arsyeja e paraqitur nuk ka baza për t'u quajtur një mungesë e arsyeshme. Shembuj të mungesave pa arsye përfshijnë (por nuk kufizohen); të kesh qënë dado fëmijësh, të zgjohesh vonë, ose kur ke qënë me pushime familjare. Për më tepër informacion për mungesat dhe largimet pa leje, shikoni websajtin - <http://webgui.phila.k12.pa.us/offices/a/attendance--truancy>

Pasojat për Mos Frekuentimin (Largimet pa Leje)

Një nxënës, i cili mungon pa arsye 3 ose më shumë ditë, konsiderohet "që ka lënë" orën e mësimi. Kur nxënësi mungon, shkolla duhet të njoftojë prindin/kujdestarin me shkrim. Nëse fëmija vazhdon me mungesat pa arsye, shkolla fton familjen në një takim për përmirësimin e mungesave. Në këtë takim diskutohen arsyet e mungesave dhe hartohet një plan për të ndihmuar fëmijën.

Një nxënës që mungon 6 (gjashtë) ose më shumë ditë shkollorë gjatë vitit shkollor, konsiderohet nxënës që mungon vazhdimisht. Në raste të tilla fëmija dhe familja mund të referohet në Gjykatën e Mungesave pa Arsye, ose në DHS, në vartësi të moshës së fëmijës. Përpara referimit në Gjykatën e Mungesave pa Arsye, ose në DHS, shkolla duhet të ftojë familjen për një takim përmirësimi të mungesave dhe të krijojë një Plan Mbështetjeje për Përmirësimin e Frekuentimit (MTSS). Shkolla duhet të dorëzojë këtë plan në çdo rast referimi.

Kur një fëmijë referohet në Gjykatën e Mungesave pa Arsye, do të caktohet një punonjës që menaxhon këtë rast, i cili punon me familjen për përmirësimin e frekuentimit.

Fëmija dhe prindi/kujdestari do të kërkohet të paraqiten në Gjykatën e Mungesave pa Arsye për të diskutuar mungesat e fëmijës. Prindi /kujdestari duhet të veprojë sipas urdhërimit të Gjykatës së Mungesave pa Arsye. Urdhëri i gjykatës mund të përfshijë edhe një referim për shërbime. Nëse frekuentimi i fëmijës nuk përmirësohet, gjykatësi mund të urdhërojë që fëmija të largohet nga shtëpia e tij dhe të vendoset në kujdestari tjetër.

Pezullimi ose transferimi nga shkolla, në një institucion tjetër mësimor, nuk është masë e lejuar për mosfrekuentimin

Për më tepër informacion për procedurat për Frekuentimin dhe Mungesat, vizitoni uebsajtin e Drejtorisë Arsimore: <http://webgui.phila.k12.pa.us/offices/a/attendance-truancy>.

Vizitat në Kampuse

Prindërit dhe kujdestarët janë të mirëpritur në shkollë dhe në takimet me mësuesit dhe administratorët, për progresin e fëmijëve të tyre. Vizitorët në godinën e shkollës duhet të paraqiten në sekretari, ose të kenë leje nga drejtori. Për të siguruar një mjedis mësimor të rregullt dhe të sigurtë, vizitori duhet të ketë autorizim nga drejtori i shkollës, ose i caktuari

prej tij.

Kodi i sjelljes së Nxënësit Zbatohet tek të gjithë nxënësit edhe gjatë kohës së vajtje-ardhjes nga shkolla në shtëpi, duke përdorur çfarido lloj mjeti transporti, si edhe gjatë veprimtarive shkollore. Në vazhdim Kodi zbatohet edhe në rastet kur sjellja edhe pas përfundimit të mësimit prish mjedisin mësimor të shkollës.

Referimet në Policinë e Filadelfias

Disa shkelje të Kodit të Sjelljes së Nxënësit, janë klasifikuar si krime nga qyteti dhe shteti. Krimet sipas ligjit duhet të raportohen në Departamentin e Policisë së Filadelfias. Memorandumi i të Kuptuarit (MOU) liston krimet që *duhen* raportuar në Policinë e Filadelfias. Në

vazhdim, Drejtoria Arsimore e Filadelfias, ka një Memorandum të Kuptuarit me Departamentin e Policisë të Filadelfias ku theksohet Programi i Diversionit, si një alternativë e arrestimit dhe ndjekjes penale.

Kur aplikohet Kodi?

Memorandumin i Të Kuptuarit (MOU), është i publikuar në uebsajtin e Drejtorisë Arsimore të Filadelfias - <http://philasd.org/announcements/MOU-Between-PPD-and-SDP-2014.pdf>

Departamenti i Policisë së Filadelfias nuk do të arrestojë një nxënës, nëse nxënësi nuk ka kryer shkelje të dhunëshme dhe nuk ka histori arresti të mëparshme. Në këto raste ai do të trajtohet nga shërbimet e Departamentit të Shërbimeve Njerëzore.

Drejtorët, mësuesit dhe personeli tjetër i shkollës, presin shumë nga nxënësit në drejtim të mësimit dhe të sjelljes. Të rriturit në shkolla i ndihmojnë nxënësit të arrijnë sukses personal dhe mësimor duke përdorur një gamë të ndryshme veprimesh.

Strategjitë e menaxhimit të klasës mund të përfshijnë si më poshtë:

- Tërhiqni vëmendjen e nxënësit në emër dhe me zë të ulët.
- Bisedoni me nxënësin privatisht.
- Theksoni sjelljen jo të rregullt.
- Theksoni sjelljen e pritëshme dhe përse nxënësi duhet të ndjekë këtë sjellje.
- Dëgjoni përgjigjen e nxënësit dhe rrokni mundësinë për të ndihmuar atë me sjellje të ndryshme.
- Përcaktoni pasojat specifike nëse kjo sjellje vazhdon- dhe pasojat pozitive nëse ai ndryshon.
- Kërkoni që nxënësi të demonstrojë sjelljen e duhur.
- I bëni të ditur nxënësit për vëmendjen tuaj dhe/ose qëndrimin e duhur të tij (p.sh. falenderime, vlerësime, dhe shpërblime)
- Dokumentoni shkeljet disiplinore në raportin disiplinor (EH20-forma ngjyrë rozë).
- Për më tepër informacion rreth strategjive menaxhuese, ju lutemi telefononi Zyren e Klimës dhe Sigurisë së Shkollës.

Ndërhyrjet në shkollë mund të përfshijnë:

- Ndërtoni kontrata për sjelljen me nxënësin
- Dënim përpara, ose mbas shkolle
- Shërbime vullnetare të ndryshme (p.sh në kuzhinë, në fjetore)
- Shërbim në menci
- Veprime korrektuese-takime me komunitetin
- Referim te Këshilltari i shkollës për këshillim individual/në grup dhe vlerësim të sjelljes individuale e lidhjeve rrethore
- Detajim i punës në shkollë
- Dënim për vaktin e drekës
- Vrojtim nga prindi
- Ndërmjetësim i shokut
- Ese reflektive për veprimin
- Studim të pavarur
- Takim prind -mësues-nxënës
- Raportim të përditshëm

Devijimi i Programit

- Praktika të veprimeve përmirësuese
- Program kujdestarie
- Kontroll për Hyrje/Daljet
- Programe të Tier II bazuar në evidenca
- Vlerësim të Sjelljes Funktionale, për Planifikimin, Zbatimin dhe Monitorimin në Progres të Sjelljes Individuale
- Për më tepër informacion rreth ndërhyrjeve në shkollë, ju lutemi telefononi Zyrën e Klimës dhe Sigurisë së Shkollës.
- Referim për SAP (Program i Asistencës së Nxënësit) për Vlerësimin e Shëndetit Mendor dhe referimin e duhur në Programin Kurues me bazë në shkollë (STS, CASST)
- Takim të përbashkët midis shkollës, Prindit, dhe institucionit që ofron ndihmë mjekësore
- Për më tepër informacion rreth ndërhyrjeve individuale ndaj sjelles dhe programeve kuruese në shkolla, ju lutemi telefononi Zyrën e Parandalimit dhe Ndërhyrjes
- Për rastet e krizave mendore/të sjelljes, ju lutemi telefononi Linjën e Krizave Urgjente në: 267-784-7895
- Për pretendime në lidhje me abuzime/neglizhencë, ju lutemi telefononi "ChildLine" në: 800-932-0313

Përdorni pezullimet jashtë shkollës, si mundësi e fundit dhe vetëm kur ndërhyrjet dhe/ose pasojat e pezullimeve në shkollë nuk japin rezultate për ndryshimin e sjelljes së nxënësit.

Sjelljet që Ndëshkohen	Rregulli	Nivelet e Pasojave				
		Niveli 1: Ndërhyrjet në Shkollë (përfshijnë pezullimet në shkollë)	Niveli 2: Pezullimet jashtë shkollës	Niveli 3: Kontratë me Ndërhyrje, ose Transferim të njëanshëm	Niveli 4: Kaktimi në shkollë tjetër	Niveli 5: Kaktimi në shkollë tjetër me referim për përjashtim
Nuk arrin të ndjekë rregullat në klasë/përçarje	1A	✓				
Mosmbajtja e lejes me shkrim në korridore (<i>hall pass</i>) ose I.D.-në e duhur	1C	✓				
Mungesa të pajustificuara/vonesa të shumta/lënia e orës së mësimi	2	✓				
Mbajtja e artikujve personalë jo të përshtatshëm	3B	✓				
Përdorimi i një fjalori apo gjeesteve të pahijëshme dhe të turpëshme	4	✓				
Përdorimi i papërshtatshëm i paisjeve elektronike	5B	✓	✓	✓	✓	✓
Rrahje (dy nxënës angazhohen në zënie të përbashkët)	6	✓	✓			
Falsifikimi i firmës së administratorit, mësuesit apo prindit	7	✓	✓			
Ndryshimi i notave në dëftesë, shënimeve të justifikimeve të mungesave dhe/ose dokumentave të shkollës	8	✓	✓	✓	✓	
Shkatërrimi dhe/ose vjedhja e pronës (më pak se \$500)	9	✓	✓	✓		
Ngacmimi (përfshirë ngacmimi seksual)	10A	✓	✓	✓	✓	✓
Bullingu (edhe ai me mjete elektronike)	10B	✓	✓	✓	✓	✓
Kërcënimi	10C	✓	✓	✓	✓	✓
Aktet seksuale (me pëlqim të palëve, konsensuale)	11	✓	✓	✓		
Kërcënimi i nxënësve, ose personelit të shkollës nëpërmjet goditjeve të rënda	12		✓	✓	✓	✓
Shkatërrimi dhe/ose vjedhja e pronës (më shumë se \$500)	13		✓	✓	✓	
Thyerje dhe futja pa leje në pronën e shkollës	14		✓	✓	✓	
Grabitje	15A		✓	✓	✓	✓
Zhvatje	15B		✓	✓	✓	✓
Goditjet e rënda (dëmtime serioze të dokumentuara trupore)	16		✓	✓	✓	
Goditje të thjeshta ndaj një pjestari të komunitetit të shkollës	17		✓	✓	✓	
Mbajtja e pijeve alkoolike dhe/ose drogës	18		✓	✓	✓	✓
Mbajtja/përdorimi i fishekzjarreve, ose të mjeteve të tjera eksplozive/ ndezëse	19		✓	✓	✓	✓
Pjesëmarrja në sulmet në grup	21		✓	✓	✓	✓
Goditjet e rënda	22			✓	✓	✓
Aktet seksuale (pa pëlqimin e palëve, jo konsensuale)	23		✓	✓	✓	✓
Mbajtja e armës	24				✓	✓
Rrezikon me veprime të pamatura	25		✓	✓	✓	✓

* Nivelet e Ndërhyrjeve nuk përjashtojnë njëri tjetrin. P.sh, nëse një nxënës është referuar në Zyrën e të Drejtave dhe Përgjegjësive të Nxënësit, ky nxënës gjithashtu do të pezullohet nga shkolla për një periudhë nga 1-10 ditë. Masat disiplinore aplikohen VETEM për nxënësit e klasave 6-12. NUK ka pezullim jashtë shkolle për thyerjet që parashtrihen në : 1A,1B,1C,1D, 2, 3B dhe 4. Nxënësit e Kopështit nuk mund të pezullohen, përderisa të mos kenë kryer shkelje të dhunëshme. Çdo pezullim mbi 3 ditë duhet të miratohet nga një Zëvendës Superintendent.

Në përputhje me Aktin 26, Superintendenti ose i caktuari prej tij, mbas seancës dëgjimore mund të lejojë, që një nxënës që ka sjellë armë në shkollë, të vazhdojë në atë shkollë

Nxënësit që kanë kryer veprime në shkelje të Kodit të Sjelljes së Nxënësit, sipas përcaktimeve të këtij seksioni mund të jenë subjekte të ndërhyrjeve dhe pasojave sipas nivelit të përshkruar në Seksionin e Ndërhyrjeve dhe Pasojave të këtij Kodi.

1A Nuk arrin të ndjekë rregullat në klasë/përçarje:

të ngrënit, të pirit, të qënit i zhurmshëm, vrapimi, hedhja e objekteve si edhe sjellje të tjera të cilat prishin mësimin e të tjerëve, ose të mësuesit .

1C Mosmbajtja e lejes me shkrim në korridore (*hall pass*) ose I.D.-në e duhur

Mospasja në mjediset e shkollës së hall-pass, ID së nxënësit, ose ID së shtetit.

2 Largim nga Shkolla/Vonesa të Tepruara/Lënia e mësimit

Nxënësit që vijnë me vonesë në klasë 10, ose më shumë herë, nuk ndjekin klasën e caktuar, ose lënë shkollën pa leje.

3B Mbajtja e artikujve personalë jo të përshtatshëm

Nxënësit që kanë kontroll fizik mbi (edhe ato që janë në dollapin personal, ose çantë) çdo objekt që është i papërshtatshëm për qëllime edukative (të humbura, të gjetura, ose të vjedhura), (përfshirë pornografi, zare, letra bixhozi dhe produkte që përmbajnë duhan, cigare elektronike, etj. Kjo nuk përfshin shishe uji, paisje higjene, ose kozmetike.

4 Përdorimi i një fjalori apo gjesteve të pahijëshme dhe të turpëshme

Nxënësit që shajnë, përdorin gjuhë seksuale me fjalë dhe gjeste.

5B Përdorimi i papërshtatshëm i paisjeve elektronike

Përfshin, por nuk kufizohet me mesazhe seksuale(seksing), regjistrime skena dhune, regjistrime në mjedise private, ose postimi i videove të parregullta në mediat sociale, të cilat e paraqesin komunitetin e shkollës në mënyrë negative.

6 Rrahje (dy nxënës angazhohen në zënie të përbashkët)

Kur një ose më shumë nxënës, përfshihen në zënie pa dalluar se cili është viktimja dhe cili agresori

7 Falsifikimi i firmës së administratorit, mësuesit apo prindit

Nxënësit që falsifikojnë firmën e tjetrit me qëllim përfitimi

8 Ndryshimi i notave në dëftesë, dhe/ose dokumentave të shkollës:

Nxënësit që me qëllim përfitimi ndryshojnë notat, shënimet shkollore, ose dokumentat zyrtare të shkollës.

9 Shkatërrimi dhe/ose vjedhja e pronës (më pak se \$500)

Veprim keqëdashës i qëllimshëm ndaj pasurisë së shkollës, që përfshin por nuk kufizohet me shkarravitjet, dëmtimet dhe zjarrvënien.

10A Ngacmimi (përfshirë ngacmimi seksual)

Sjellje e pa pëlqyeshme e natyrës seksuale, që përfshin veprime të papranueshme seksuale, kërkesë për favore seksuale dhe sjellje të tjera verbale dhe jo verbale, ose fizike, të natyrës seksuale.

10B Bullimi (edhe ai me mjete elektronike)

do të thotë sjellje e qëllimshme, që parandalon, dekurajon, ose (1) vë në rrezik të drejtën e arsimimit të një nxënësi tjetër, ose (2) krijon një mjedis armiqësor mësimi dhe (3) prish veprimtarinë e shkollës. Bullimi shfaqet nga mosbalanca mes të fortit dhe të dobtit (përsa i përket seksit, fuqisë fizike ose mendore, pranimit në shoqëri). Këto sjellje të ndaluara përfshijnë ushtrimin e dhunës, forcës, ngacmimit të përsëritur, abuzimit/sharjes, presionit, kërcënimit me gojë, shkrim dhe elektronik. Bullimi elektronik shfaqet nëpërmjet mjeteve elektronike dhe përfshin, por nuk kufizohet nga rrjetet sociale, emailt, tekst mesazhet, etj

10C Kërcënimi

Të futësh frikë, ose ndjenjë inferioriteti ndaj një nxënësi tjetër, ose pjestari të komunitetit të shkollës.

11 Aktet seksuale (me pëlqim të palëve, konsensuale)

Nxënësit që në mjediset e shkollës, ose në aktivitetet e saj tentojnë marrdhënie seksuale, seks oral, prekje të organeve seksuale, ose seks i simuluar, me dëshirën e njëri-tjetrit.

12 Kërcënimi i nxënësve, ose personelit të shkollës nëpërmjet goditjeve të rënda

Nxënësit që kërcënojnë, përdorin gjuhë verbale, me shkrim, ose gjeste agresive, komunikojnë një kërcënim terrorist, një veprim që shkakon dëmtim fizik serioz, ose krijojnë rrezik serioz për një nxënës tjetër, dhe/ose pjestar të komunitetit të shkollës.

13 Shkatërrimi dhe/ose vjedhja e pronës (më shumë se \$500)

Veprim keqëdashës i qëllimshëm ndaj pasurisë së shkollës, që përfshin por nuk kufizohet me shkarravitjet, dëmtimet dhe zjarrvënien.

14 Thyerje dhe futja pa leje në pronën e shkollës

Nxënësit që futen pa leje në çdo pronë që zotëron ose përdor Drejtorja, si dhe pronën në përdorim të çdo kompanie, që është në kontratë me Drejtorinë, përmes forcës (qoftë edhe minimale, kur shtyhet një derë) dhe pa autorizim

15A Grabitje

Marrja, ose tentativa për rrëmbimin e pasurisë së një nxënësi tjetër, ose pjestari të komunitetit me forcë, kërcënimin e forcës, ose frikësimin e viktimës.

15B Zhvatje

Përfitimi i parave, pasurisë, ose shërbimeve nga një nxënës tjetër nëpërmjet detyrimit

16 Goditjet e rënda (dëmtime serioze të dokumentuara trupore)

do të thotë një akt që shkakton dëmtime të rënda dhe serioze fizike, ose krijon një rrezik të konsiderueshëm dëmtimi fizik të një anëtari tjetër të komunitetit të shkollës

17 Goditje të thjeshta ndaj një pjestari të komunitetit të shkollës

Nxënësit që pa u provokuar qëllojnë, shtyjnë, godasin një pjestar të komunitetit të shkollës.

18 Mbajtja e pijeve alkoolike dhe/ose drogës

përfshijnë substancat e kontrolluara dhe ato ilegale, si edhe ato “të ngjashmet” me ato substanca, nisur nga pamje, paraqitja ose mënyra e shpërndarjes, që mund të çojnë një njeri të arsyeshëm në gjykimin se është substancë ilegale ose e kontrolluar.

19 Mbajtja/përdorimi i fishekzjarreve, ose të mjeteve të tjera eksplozive/ ndezëse:

Nxënësit që kanë kontroll mbi (përfshirë dollapin, qese, rroba) të fishekzjarreve, paisjeve ndezëse, bombave dhe eksplozivëve të tjerë.

21 Pjesëmarrja në sulmet në grup

Një sulm i kryer nga kundërvajtës të shumtë ndaj një ose më shumë viktimave. Kjo nuk referohet për përleshje në grup, por kur një ose më shumë viktima sulmohen nga një grup i madh agresorësh.

22 Goditjet e rënda

Një akt që shkakton dëmtime të rënda dhe serioze fizike, dhe/ose krijon një rrezik të konsiderueshëm dëmtimi fizik të një anëtari tjetër të komunitetit të shkollës

23 Aktet seksuale (pa pëlqimin e palëve, jo konsensuale)

Nxënësit që në mjediset e shkollës, ose në aktivitetet e saj tentojnë në marrdhënie seksuale, seks oral, prekje të organeve seksuale, ose seks i simuluar, pa dëshirën e tjetrit (përfshirë detyrimin e tjetrit për sjellje seksuale).

24 Mbajtja e armës:

nënkupton të gjitha, por që nuk kufizohet, si më poshtë- thikat, mjete që presin, vegël prerëse, armë zjarri, pushkë gjahu, dyfek, gërshërë dhe ndonjë vegël tjetër. Kjo nuk përfshin objektet e zakonshme si lapsat

25 Rrezikon me veprime të pamatura

Të futesh me mendjelehtësi në veprime të cilat të çojnë, ose mund të çojnë një person tjetër në rrezik për lëndime serioze.

Zhvillim i një gjykimi të barabartë

Të gjithë nxënësit duhet të trajtohen me drejtësi dhe ndershmëri. Nxënësit kanë të drejtën të dëgjohen dhe të dëshmojnë versionin e tyre të ngjarjeve.

Nëse ju besoni se fëmija juaj është viktimë, ju jeni të inkurajuar të kontaktoni me Zyrën e Avokatit për Shkollë të Sigurtë në <http://www.phillyossa.com>, ose

telefononi 215-656-5381.

Nxënësit do të presin që nga nëpunësi i caktuar në takimin formal, të bëhet:

1. Njoftimi i nxënësit mbi arsyen e takimit
2. Dhënia e mundësisë nxënësit për t'u përgjigjur pretendimit/meve
3. Diskutimi i sjelljes së nxënësit dhe rrugëve për ndreqjen e saj
4. Informimi i nxënësit për masat korrektuese dhe/ose hapave të tjera
5. Dokumentimi i sjelljes dhe ndërhyrjes

Procedurat e Takimeve me Nxënësin

Sipas Ligjit Shtetëror të Pensilvanisë, pezullimi nga shkolla përcaktohet si mohimi i të drejtës së nxënësit për të ndjekur shkollën dhe për të marrë pjesë në çdo aktivitet tjetër të saj për një periudhë kohore deri në 10 ditë. Pezullimet duhet të paraprihen nga njoftimi me shkrim i nxënësit dhe prindit/kujdestarit Për qëllimet e Kodit të Sjelljes së Nxënësit të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias, pezullimi nga shkolla do të klasifikohet në tre kategori: *Në shkollë, Me afat të shkurtër dhe Afat të gjatë*

Procedurat e Pezullimit

Pezullimet në Shkollë

Pezullimi në shkollë është një largim nga klasa për qëllime disiplinore, por nxënësi **mbetet** nën mbikëqyrjen direkte të personelit të shkollës. Mbikëqyrje direkte do të thotë, që personeli i shkollës është në të njëjtin ambient me nxënësin

Pezullimet Jashtë Shkollës

Nxënësit e kopështit nuk mund të pezullohen për raste të tjera, përveçse kur veprimet e tyre sjellin dëmtime serioze trupore

Pezullim me afat të shkurtër është një përjashtim nga shkolla dhe/ose nga çdo aktivitet i saj, për një periudhë kohe **deri në 3 ditë mësimi ose më pak**. Nxënësit, të cilët janë përjashtuar, do të takohen me drejtorin e shkollës ose personin e caktuar, para marrjes së masës të pezullimit. Gjatë këtij takimi, nxënësi ka të drejtën e procedurave të përshkruara, sipas *Procedurës së Bashkëbisedimit me Nxënësin* të parashtruara në Kodin e Sjelljes së Nxënësit.

Pezullim me afat të gjatë është një përjashtim nga shkolla dhe/ose nga çdo aktivitet i saj për një periudhë kohe nga **4 deri në 10 ditë mësimi**. Nxënësve, të cilëve u është dhënë përjashtimi me afat të gjatë, do të kenë një takim të nxënësit dhe të prindit. Gjatë këtij takimi, nxënësi dhe prindi kanë të drejtën e procedurave të përshkruara sipas *Procedurave të Bashkëbisedimit me Prindin*, të parashtruara në Kodin e Sjelljes së Nxënësit. **Në vazhdim kërkohet miratimi paraprak nga Zv. Kryetari i Zyrës të Të Drejtave dhe Përgjegjësive të Nxënësve, për të gjitha rastet e pezullimit afatgjatë me më shumë se tetë (8) ditë shkollë.**

Procedurat e Takimeve me Prindërit

Të gjitha referimet për në Zyrën e Të Drejtave dhe Përgjegjësive të Nxënësve, për një seancë dëgjimore, duhet të paraprihen nga një pezullim jashtë shkollës.

Prindërit, kujdestarët do të presin që nga nëpunësi i caktuar në takimin formal, të jetë ndjekur procedura e mëposhtme :

1. Njoftimi i takimit për bisedim duhet t'u jepet prindërve/kujdestarëve me shkrim dhe të dorëzohet dorazi, dërgohet me postë të çertifikuar faksohet, dërgohet me email, ose me ndonjë mjet tjetër të arsyeshëm për të kontaktuar .
2. Kur një nxënës pezullohet nga mësimi, takimi për bashkëbisedim me prindin duhet të mbahet brenda tre (3) ditësh nga dita e pezullimit
3. Në takim, prindi mund të kërkojë të rishikojë dhe të ketë një kopje nga rekordet e nxënësit dhe ndonjë dëshmi me emrat e nxënësve dhe informacionin e reduktuar
4. Administratorët e shkollës do të diskutojnë sjelljen e nxënësit dhe rrugët për ndreqjen e sjelljes së tij
5. Administratorët e shkollës do të njoftojnë prindin/kujdestarin për masa të mëtejshme disiplinore

Proçedurat e transferimeve për masat disiplinore të Nxënësit

Për Nxënësit në Klasat K-5 Nuk aplikohet proçedura dëgjimore e masave disiplinore. Before a suspension can be issued for a student in 1st or 2nd grade, referrals for various interventions must be made and documented. Please refer to page 7 of the Code of Conduct for further details. Në vend të kësaj proçedure, në rastet e thyerjeve disiplinore të rënda, ose të sjelljeve të papërshtatëshme, ata do të

referohen në proçesin e Multi-tiered Systems of Support (MTSS).

Nxënësit nga klasa e 6 deri 12, që nuk arrijnë sukses, për shkak të një sjelljeje të keqe të vazhdueshme, dhe/ose thyerje serioze të Kodit të Sjelljes së Nxënësit, mund të referohen në Zyrën e të Drejtave dhe Përgjegjësi të Nxënësve. Nxënësit e referuar marrin pjesë në një proçes të plotë, përfshirë seancë dëgjimore për të përcaktuar nëse nxënësi do të transferohet në një shkollë tjetër alternative. Këto shkolla ofrojnë një program edukativ të një cilësie të lartë dhe punojnë për të përgatitur, garantuar dhe mundësuar, që të gjithë nxënësit të arrijnë potencialin e tyre të plotë social dhe intelektual.

Çdo nxënës, i referuar për seancë dëgjimore, gjithashtu mund të pezullohet dhe t'i tregohen proçedurat e përcaktuara në Proçedurat e Pezullimit, të parashtruara në këtë Kod të Sjelljes. Shkolla duhet të plotësojë një Përmbledhje të Performancës së Sjelljes (BPR), për nxënësit e rregullt, ose Manifestim të Vendosmërisë (Manifestation Determination), për nxënësit e Edukimit Special dhe t'i paraqesë rezultatet e kësaj përmbledhjeje në takimin me prindin.

Kur seanca dëgjimore nuk është planifikuar gjatë kohës së pezullimit të nxënësit, ky ka të drejtën të kthehet në shkollën e tij deri në përfundim të proçesit dëgjimor, përveç rasteve kur sjellja e nxënësit krijon probleme dhe dëmton komunitetin e shkollës, dhe në këto raste shkolla mund të kërkojë një largim të përkohshëm. (Shih më poshtë për detajet e këtij proçesi)

Nxënësit/Prindërit/Kujdestarët kanë të drejtën e një seance dëgjimore të drejtuar nga një nëpunës i pavarur për të kundërshtuar këtë transferim.

Nxënësi dhe Prindi/Kujdestari gjatë kësaj seance dëgjimore mund të:

- Paraqesë dëshmitarë;
- Paraqesë dëshmi të tija që lidhen me rastin
- Kërkojë dhe ripyese dëshmitarët e Drejtorisë Arsimore; dhe
- Rishikojë paraprakisht rekordet e nxënësit

Në rast se nëpunësi i seancës dëgjimore vërteton thyerjet e disiplinës ai/ajo përcakton masën në përputhje me shkëljen e kryer.

Shkollat mund të kërkojnë një transferim të përkohshëm për nxënësit e edukimit të rregullt me dokumentimin e faktit që qenia e nxënësit në këtë shkollë paraqet një kërcënim për komunitetin e shkollës. Në këto raste kur jepet transferimi i përkohshëm nga Zyra e të Drejtave dhe Përgjegjësi të Nxënësit, seanca dëgjimore duhet të mbahet sa më shpejt. Për nxënësit e edukimit special masa e transferimit të përkohshëm do të aplikohet vetëm në rastet kur dokumentohen mbajtje arme, droge, ose dëmtime serioze

Shënim: Ju lutemi referojuni **seksionit Disiplinor për Nxënësit me Paaftësi** për protokollin e masave disiplinore, për nxënësit me paaftësi

Sipas Ligjit Shtetëror të Pensilvanisë, pezullimi nga shkolla përcaktohet si: mohimi i të drejtës së nxënësit për të ndjekur shkollën dhe për të marrë pjesë në çdo aktivitet tjetër të saj për një periudhë kohore deri në 10 ditë. Nxënësit që kanë kryer një shkelje disiplinore-subjekt i përjashtimit- do të përjashtohen, por kanë të drejtën proçeduriale që përshkruhet në seksionin e Proçedurave të Pezullimit të Kodit të Sjelljes së Nxënësit.

Proçesi dëgjimor për përjashtimin, përfshin edhe kërkesat e mëposhtëme:

1. Njoftim me postë rekomande për akuzat e ngritura, prindit/kujdestarit të nxënësit.

2. Së paku 3 (tre) ditë përpara proçesit, duhet të njoftohet vendi, ora dhe proçedurat e seancës dëgjimore, një kopje të kësaj politike dhe njoftimin se nxënësi ka të drejtë të përfaqësohet me avokat. Nxënësi mund të kërkojë shtyrjen e seancës, kur ai/ajo paraqet një arsye bindëse për shtyrjen.

3. Seanca dëgjimore do të jetë private, dhe mund të bëhet publike vetëm nëse prindi/kujdestari, ose nxënësi e dëshirojnë atë.

4. Përfaqësimi nëpërmjet këshilltarit me shpenzimet e prindit/kujdestarit, ku prindi/kujdestari mund të asistojnë në proçesin dëgjimor.

5. Afishimin e emrave të dëshmitarëve që janë kundër nxënësit, dhe kopje të dëshmive të tyre me shkrim, ose nën betim.

6. Të drejtën që të kërkojnë paraqitjen fizike të dëshmitarëve dhe që t'u përgjigjen pyetjeve, ose ballafaqimeve.

7. Të drejtën që të paraqesë dëshmitarë dhe dëshmi në favor të tij.

8. Proçesi do të regjistrohet me audio, ose me shkrim dhe një kopje mund të vihet në dispozicion të nxënësit me shpenzimet e veta, ose falas kur ai është i varfër.

9. Proçesi do të realizohet brenda 15 ditëve shkollore, nga dita e njoftimit të shkejeve, përjashtohen rastet, kur vonesa bëhet me pëlqimin e përbashkët të palëve, ose shtyhet për:

- a. Nevojat e paraqitjes së raporteve laboratorike nga institucionet e zbatimit të ligjit.
- b. Vlerësim ose proçese të tjera të detyruara nga gjyqi për shkak të kërkesës së nxënësit për të drejtat e tij/saj, që burojnë nga Akti për Edukimin e Individëve me Paaftësi (IDEA).
- c. Shtyrja është e nevojshme për shkak të konditave, ose interesit të viktimës, në rastet e gjykatës për të rinjtë, kur ka patur sulme seksuale, ose lëndime trupore serioze.

10. Njoftimi për të drejtën e apelimit të rezultatit të proçesit dëgjimor, duhet të paraqitet për nxënësit ndaj të cilit është marrë masa e përjashtimit

Proçedurat e Përjashtimit

Transferimi i Përkohshëm

Procedurat e Përrjashtimit (vazhdim)

Nëse një nxënës është përjashtuar nga SRC, prindi/kujdestari i nxënësit, ka 30 ditë kohë që të parashtrijë, dokumenta me shkrim, se nxënësi është në një tjetër program mësimor. Nëse ata nuk janë në gjendje të gjejnë një program mësimor alternativ, Drejtoria Arsimore do të kujdeset për arsimimin e nxënësit. Një nxënës që ka qenë i përjashtuar përgjithmonë, nga shkollat e Drejtorisë Arsimore të Filadelfias, nëpërmjet votimit me shumicë në Komisionin e Reformës Shkollore (SRC), mund të aplikojë për ripranim.

SRC e delegon autoritetin e plotë për ripranim të nxënësve të përjashtuar, te Superintendenti, ose i ngarkuari i tij. Nxënësit e përjashtuar përkohësisht, nuk kanë nevojë të aplikojnë për t'u pranuar, pasi me mbarimin e datës së dënimit, ata janë automatikisht të pranuar në Drejtorinë Arsimore. Vendimet për ripranim janë përfundimtare dhe nuk mund të apelojnë në SRC, ose Gjyq.

Një nxënës, i cili ka qenë përjashtuar përgjithmonë ose përkohësisht, nga votimi në shumicë i Komisionit të Reformës Shkollore, duke filluar nga viti shkollor 2008-2009, mund të aplikojë në Drejtorinë Arsimore të Filadelfias, për fshirjen (parashkrimin) e rekordeve të përjashtimit. Vendimi i fshirjes është në tagrin e Superintendenti, ose të caktuarit prej tij dhe nuk janë subjekt i rishikimit, ose apelit në SRC, ose në gjyq.

Për Politikën e Plotë të SRC No. 233 me kriteret dhe procesin e ripranimit dhe/ose fshirjes së rekordeve, shkoni në uebsajtin <http://www.philasd.org/offices/administration/policies>

Pezullim për Nxënësit e Edukimit Special të Identifikuar si të Paaftë Intelktualisht ("MR")

Disiplina për Nxënësit me Paaftësi

Drejtoria Arsimore mund të pezullojë nga mësimi nxënës të identifikuar si Paaftë Intelktualisht, vetëm me një marrëveshje me shkrim të prindit/kujdestarit, ose me aprovimin me shkrim nga Zyra e Arsimit Special të Departamentit të Arsimit të Pensilvanisë (PDE). PDE, mund të kontaktohet në numrin: (717) 783-6913, ose në uebsajtin - <http://www.pde.state.pa.us>

Pezullimi, Përrjashtimi dhe Transferimi i Nxënësve të Tjerë me Paaftësi – Përrfshirë Nxënësit me Marrëveshje Shërbimi 504

Drejtoria Arsimore mund të pezullojë nxënësit me paaftësi nga mësimi dhe të ndalojë dhënien e shërbimit arsimor për deri në 5 ditë mësimore rresht, ose 15

ditë mësimore të mbledhura në total gjatë një viti shkollor, pa ofruar të gjitha procedurat arsimore mbrojtëse.

. Shkollat duhet të plotësojnë fazat e mëposhtme nga A deri G për nxënësit me IEPS, ose Seksioni 504 për Marrëveshjet e Shërbimeve, nëse ndonjëra nga ato do të merret në konsideratë:

1. Referim për Përrjashtim.
2. Kërkesë për Transferim në një Shkollë Alternative, për arsye disiplinore (shkolla duhet të plotësojë formën EH-21).
3. Pezullim për më shumë se 10 ditë radhazi.
4. Pezullim për më shumë se 15 ditë të akumuluar.
5. Pezullim në total më shumë se 10 ditë, në një vit mësimor dhe kur ka një "model" të sjelljes.

FAZAT:

Një ekip do të organizojë një takim brënda 24 orësh, ku do të jenë të ftuar edhe prindërit/kujdestarët. Ekipi duhet të:

- A) Paraqesë me shkrim për prindin/kujdestarin e nxënësit, rekomandimet për masat disiplinore dhe datën e takimit për të analizuar problemet që ka nxënësi nëpërmjet një Programi të Individualizuar Edukimi (IEP);
- B) Gjatë takimit të IEP-së, ekipi i IEP-së do të rishikojë vlerësimin më të fundit të nxënësit, për të përcaktuar nëse sjellja e keqe e nxënësit lidhet apo jo me paaftësinë e tij. Dy pyetje duan përgjigje gjatë këtij takimi, nga ana e shkollës: (1) Sjellja e keqe nuk është e lidhur me paaftësinë e nxënësit, ose (2) IEP-ja aktuale nuk është implementuar si duhet nga shkolla;
- C) Nëse, sjellja e nxënësit **NUK vjen si pasojë e Gjymtimit**, nëpunësit e shkollës mund të kërkojnë të zbatohet Kodi i Sjelljes së Nxënësit. Në asnjë rast nxënësi s'mund të pezullohet më shumë se 5 ditë rresht ose 15 ditë në vit, pa i siguruar shërbimet e duhura në edukimin e tij.
- D) Njoftimi mbi Caktimin e Nxënësit në Shkollën e Rekomanduar (NOREP) do të jepet bashkë me rezultatet e këtij vendimi dhe një kopje të bashkë me Procedurat për Shërbime (PSN), do t'i jepen prindit/kujdestarit

***Nëse prindi nuk është dakort me vendimin, mund të kërkohet një seancë e përrsheptuar dëgjimore e edukimit special dhe zyrtari i caktuar do të rishikojë materialin e paraqitur**

- E) Ekipi i IEP-së, do të rishikojë dhe ripunojë planin e ndërhyrjes/masave për përrmirësimin e sjelljes, n.q.s është e nevojshme, ose të bëjë një plan funksional vlerësimi të sjelljes së nxënësit dhe përcaktojë ndërhyrjet e duhura;
- F) Ekipi që bën IEP do të vendosë, nëse duhet një mjedis i brendshëm edukues alternativ, dhe siç u tha më lart, në këtë IEP do të përrfshihen ato shërbime dhe modifikime, që do ta bëjnë nxënësin të aftë të vazhdojë të marrë pjesë në programin mësimor, të ndryshojë sjelljen e tij dhe të mos përrsërisë gabimet.

G) Nëse sjellja e padëshiruar e nxënësit vjen si pasojë e paaftësisë së tij, nxënësi vendoset në mjedis të ri vetëm nëse:

(1) Nxënësi ka mbajtur armë* në shkollë, ose në mjediset e saj

Disiplina për Nxënësit me Paaftësi (vazhdim)

(2) Me dijeni, ka mbajtur, përdorur, shitur, apo është munduar të shesë drogë apo substanca të ndaluara në shkollë, ose në mjediset e saj

(3) Nxënësi është përfshirë në një dëmtim serioz të një tjetri, në shkollë, ose mjediset e saj

Në këto raste të veçanta, edhe **në kundërshtim me vullnetin e prindit**, drejtuesit e shkollës mund t'a lëvizin nxënësin, duke lëshuar një Njoftim mbi Caktimin e Nxënësit në Shkollën e Rekomanduar (NOREP), në një mjedis provizor edukimi alternativ, për jo më shumë se 45 ditë.

- Nëse sjellja e padëshiruar e nxënësit vjen si pasojë e paaftësisë së tij dhe sjellja nuk është e "rasteve të veçanta" (shiko G. 1-3 më lart), Drejtorja Arsimore mund të kërkojë gjykim të shpejtuar, të drejtuar nga një nëpunës shtetëror i seancave shqyrtuese dhe t'i kërkojë përfaqësuesit të gjyimit të urdhërojë caktimin provizor për 45 ditë, nëse nxënësi ka premisa të plagosë veten apo të tjerët.
- Nxënësve me aftësi të kufizuara duhet t'u sigurohet edukimi i duhur falas (FAPE), edhe kur janë të përjashtuar.

H) ***Shënim:** "Armë e rrezikëshme", është një armë, instrument, material, ose substancë që është përdorur për, ose ka kapacitet, të shkaktojë vdekjen, ose plagosjen e rëndë. Megjithatë, rastet e thikës së xhepit, me teh më pak se dy inç e gjysëm, në gjatësi, nuk konsiderohen armë të rrezikëshme. Një paisje prerëse është një "armë e rrezikëshme"

Informacioni në këtë material mund të përditësohet gjatë vitit shkollor

Versioni më i fundit është në uebsajtin e Drejtorisë Arsimore -
www.philasd.org/

Për kopjet e ndryshme nga gjuha Angleze, ju lutemi kontaktoni
Qendrën e Përkthimeve dhe Interpretimeve me telefon
215-400-41800.

Drejtorja Arsimore e Filadelfias nuk bën diskriminime në punësim, në programet mësimore, ose aktivitete bazuar në racë, kredo, ngjyrë, origjinën kombëtare, besimin fetar, prejardhjen, moshën, statusin familjar, orientimin seksual (i njohur, ose i supozuar), shprehjen e identitetit gjinor (i njohur, ose i supozuar), seksin, paaftësinë fizike, kombësinë, shtetësinë, pjesëmarrjen në sindikata, ose aftësitë gjuhësore të kufizuara në Anglisht. Kjo politikë e mos diskriminimit shtrihet te të gjithë klasifikimet që mbrohen ligjërisht. Publikimet e këtij njoftimi janë në përputhje me ligjet e shtetit dhe Federale, përfshirë Kapitullin IX të Amendamentit për Edukimin të vitit 1972 dhe Seksionet 503 dhe 504 të Aktit të Rehabilitimit të vitit 1973



Drejtorja Arsimore e Filadelfias
Qendra Mësimore
440 North Broad Street
Philadelphia, PA 19130
215-400-4000